



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

WWW.UMED.EDU.AL



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 3077 Prot.

Tiranë, më 02.11.2022

UDHËZIM

Nr. 2 datë 02.11.2022

PËR

“APLIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE NË KUOTAT E PAPLOTËSUARA PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË INTEGRUAR TË CIKLIT TË DYTË, RAUNDI IV, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, VITI AKADEMIK 2022-2023”

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, Udhëzimit të MAS nr. 10, datë 15.05.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë” i ndryshuar, lidhur me procesin e aplikimit dhe regjistrimit në kuadër të plotësimit të kuotave të mbetura bosh në programet e studimit të ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë, Raundi IV,

UDHËZOJ:

1. Kandidatët që kanë aplikuar në raundin e tretë në programin përkatës të studimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, nuk janë të regjistruar në një program tjetër studimi, të paraqesin pranë sekretarive mësimore të njësisë kryesore (fakultetit) përkatës kërkesën me shkrim për regjistrim në atë program studimi (sipas modelit të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij Udhëzimi), në datat **3 dhe 4 Nëntor 2022**, nga ora **8:00** deri në **14:00**.
2. Njësitë kryesore (fakultetet) brenda datës **4 Nëntor**, ora **16.00** përcjellin në Rektorat listat e kandidatëve sipas renditjes. Publikimi i listave bëhet me **datë 05.11.2022** në faqen zyrtare të njësisë kryesore dhe të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Me datë **6 nëntor 2022**, bëhet regjistrimi i kandidatëve sipas renditjes së shpallur në pikës 2, pranë njësive kryesore (fakulteteve) në përputhje me kuotat e mbetura bosh, si më poshtë:
Data 6 nëntor 2022
Faza I – ora 9.⁰⁰-11.⁰⁰
Faza II – ora 11.⁰¹-13.⁰⁰
Faza III- ora 13.⁰¹-15.⁰⁰
Faza IV- ora 15.⁰¹-17.⁰⁰
4. Nëse rezultojnë ende kuota të paplotësuara pas regjistrimeve sipas pikës 3 të këtij Udhëzimi, aplikantët që rezultojnë të paregjistruar dhe janë pjesë e portalit U-Albania, paraqesin pranë sekretarive mësimore të njësisë kryesore (fakultetit) përkatëse kërkesën me shkrim për regjistrim në atë program studimi (sipas modelit të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij Udhëzimi) në **datën 7 nëntor, ora 12.00**. Njësitë kryesore (fakultetet) brenda datës **7 Nëntor**, ora **16.00** përcjellin në Rektorat listat e

kandidatëve sipas renditjes. Publikimi i listave bëhet më datë 07.11.2022 në faqen zyrtare të njësisë kryesore dhe të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Më datën 8 nëntor 2022, bëhet regjistrimi i kandidatëve sipas renditjes së shpallur.

5. Te gjithë aplikantët sipas pikës 2 dhe 4 së bashku me modelin sipas shtojcës 1, të bashkëlidhin kopje të ID dhe të diplomës së Maturës Shtetërore si dhe listën e notave të gjitha viteve të shkollës së mesme.
6. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen njësitë kryesore të UMT-së dhe sekretariatë mësimore.

REKTORI
ARBEN GJATA



Shtojca nr. 1

FORMULAR KËRKESE

Unë i nënshkruari _____, ID e maturës _____, aplikant pjesë e portalit U-Albania, paraqes kërkesën time për të vijuar konkurrimin në programin studimit _____.

- Deklaroj se nuk jam regjistruar në asnjë program tjetër studimi.
- Jam informuar nëpërmjet faqes zyrtare të njësisë kryesore (fakultetit) dhe universitetit, për Udhëzimin e Rektorit të UMT-së nr. 2, datë 2.11.2022 “Për aplikimin dhe regjistrimin e kandidatëve në kuotat e paplotësuara...”, lidhur me publikimin e renditjes dhe fazat e regjistrimit të kandidatëve.

Emër Atësi Mbiemër

Nr. telefoni: